

HYRJA E KROACIS NË BASHKIMIN EUROPIAN.

Demokraci, zgjedhjet, politika dhe shoqëria

*

Intervistë me profesorin Anđelko Milardović¹

IVANA JUKIĆ - CSABA SURÁNYI

(Abstarkt) Kroacia ka pas probleme për gati njëzet vjet dhe më në fund tani duket fundi i tyre në horizontë. Numri i të papunëve është në rritje, njerëzit janë të përbuzur dhe konstitucionalistët janë të polarizuar mes dy partive më të mëdha. Në intervistën me profesorin Milardovic ne kemi provuar të prekim temat më të rëndësishme dhe të adresojm çështje dhe pyetje në lidhje me skenën politike kroate. Ne prekëm zgjedhjet (lokale, parlamentare dhe presidenciale) si dhe anëtarësimin e Kroacisë në Bashkimi Europian. Në korrik 2013 Kroacia dë të bëhet anëtare e re e Bashkimit Europian. Anëtarësimi i Kroacisë do të ndikoj në pozicionin e saj në Europën Jug-Lindore, si dhe marrëdhënjet me vëndet fqinje: Serbia dhe Bosnia Hercegovina.

Fjali Çelës: Kroacia, Bashkimi Europian, përcaktimi minimal e demokracisë, zgjedhjet, pozicioni e Kroacisë në rajonin, euro-skepticizmi, marrëdhënjet e Kroacisë me shtetet fqinje, oligarki politike.

PËRSHKRUAJE TË ARTIKULLIT

- I. Situata politike në Kroaci.
- II. Situata politike në nivel lokal dhe zgjedhjet lokale 2013.
- III. Pozicionet kroate në rajonin europian.
- IV. Euro skepticism

*

- I. Situata politike në Kroaci.
 1. Si e vlerësoni nivelin e demokracisë ne Kroaci?

¹ Anđelko Milardović u lind në vitin 1956 në Ogulin. Studimet, mori diplomë bachelor, diplomë master dhe doktoraturë në skencat politike. Ai është një këshilltar skencor i institutit për Migrim dhe Studime Etnike. Është profesor i skencave politike në studime kroate në universitetin e Zagrebit. Ai mëson "hyrje në skenca politike", "idet bashkëkohore politike dhe ideologjitë" dhe "sosiologjia e politikës". Në 1994, ai themeloi Pan Liber shtypjen e librave në fushën e skencës politike. Si kryeredaktori 1995-2003 ai publikoi shtatëdhjetë tituj në fushën e skencave politike, sosiologjisë, politikës, historisë kulturore dhe ligjit kushtetues. Është themeluesi dhe drejtori i që ndrës për studime politike në Zagreb. Ai ishte në trajnime të studimeve të ndryshme: universiteti Georg August, Göttingen (1988), instituti për studime europiane, Bonn (1991), instituti për skenca politike, Heidelberg (1994), shoqëria austriake për letërsi, Vjenë (1994). Ka publikuar disa libra në historinë e strukturës, metodologjisë, skenca politike dhe ideologjie politike. Burimi: intervistë 09. 01. 2012, biblioteka kombëtare dhe universitare në Zagreb. <http://www.cpi.hr/>

Demokracia është një teori politike. Nuk është një tip i qartë, sepse ka disa lloje e demokracisë: kushtetuese, pjesëmarrëse, përfaqësuese, minimum, e zgjatur, e fortë. Ka shumë lloje të demokracisë, kështu mbi çdo debat për demokracinë përpara duhet të përfshirë përcaktimin e llojit të demokracisë. Kjo është vetem sundimi i shumicës, ajo mund të jetë një tirani e shumicës, si Tocqueville shkruajti në librin e tij "demokracia në Amerikë".² Demokracia demonstroi vetveten në një marrëdhënie midis shumicave dhe pakicave si dhe në marrëdhënie ndërmjet minoritetëve dhe të shumicave. Shoqëritë demokratike respektojnë zërat e grupëve të ndryshme minoritare por në të njëjtën kohë demokracia është sundimi i shumicës. Parimi i shumicës apo i pakicës mund të jetë joshëse kur flasim për demokraci, sepse mund të jetë një sundimi i shumicës, duke shikuar nga një pikë thjesht numerike, si për shëmbull, se shumica gjithmonë drejton, por në fakt shumica nuk mund të drejtoj kurrë. Shumica mund të vendosë vetëm në rastin së demokracisë drejtpërdrejt, kur ekziston një numër i vogël njerëzore, dhe ku ka një hapësirë për diskutimet dhe vendimet. Megjithatë, në rastin e shoqërive, sidomos në ato më të mëdha, ne flasim për demokracinë përfaqësuese e cila ka avantazhet dhe disavantazhet e saj. Pra, çdo bisede fillon me përcaktimin e llojit të demokracisë. Në demokracinë përfaqësuese, kur flasim për shumicat dhe pakicat dhe marrëdhënjet e tyre, minoritetet mund të ken kontrollin aktual sepse ato janë përfaqësuesit e minoritetit të caktuar, ato merren me interesat e tyre dhe jo me interesat të qytetarëve. Prandaj, ato janë pjesë të oligarkis politike. Për shëmbull, një minoritet është i fuqishëm sepse ato kanë gjithçka që kanë nevojë: ato kanë burime financiare, politike, ekonomike, kulturore dhe të tjera-këto burime bëjnë një minoritet të fuqishëm edhe brenda një demokraci, në fakt ka të bëjë me oligarkin. Është e rëndësishme të distancojmë veten nga përcaktimi popullor e demokracisë, sepse kur një njëri hyn në teorinë e demokracisë, atëherë është një histori më e ndërlikuar.

Kur është fjala për Kroacinë, si në shtete të tjera, mund të flasim për përcaktimin minimale të demokracisë. Demokracia minimale është përcaktuar nga shumë teoricienë nga Schumpeter³, Przeworski⁴ dhe nga Karl Popper.⁵ Përcaktimi minimal i demokracisë përfshin: zgjedhje të rregullta, trashëgim, dhe kuptimin që një parti fiton dhe tjetra humb. Këto janë faktorët më të rëndësishme dhe çdo gjë tjetër bie në fushën e imitimit të demokracisë në periudhën pas zgjedhore me një pjesëmarrje shumë të lartë politike e teknikave, që janë konfliktet, prodhimi i pseudo-ngjarjeve, dhe kulturës masive. Për shëmbull me ndimën të Sulejmani Madhështor, Wind Rose, zgjedhjet Lara, operat meksikane, ose dhe futbollit. Nga një anë, me ndimën të reklamave të politikanëve një imitim të demokracisë është krijuar në periudhën paszgjedhore. Sidomos në lidhje me reklamat ekonomike që na shtyjnë të blejm gjëra dhe përfundimisht të futemi në borxh. Nga ana tjetër, kemi reklama politike që na inkurajojnë të votojm për një demokraci minimale. Formula është e thjeshtë: puno, blej, konsumo, falu (referohet kishës) dhe voto. Gjërat të përmendura më parë referohen te përcaktimi minimale e demokracisë, që është demokracia me llojin pjesëmarrëse më të ulët.

2. Cila ishte, sipas vendimit juaj, ngjarja vendimtare politike në Kroaci vitin 2012?

Ngjarja më e rëndësishme ishte krijimi i parlamentin të ri dhe autoritetet ekzekutive dhe legislative në të cilën anëtarët e shoqërisë tone vendosën shpresa të mëdha lidhur me ndryshimet sociale për shkak të krizës të madhe ekonomike dhe sociale. Këto pritje ishin të larta dhe për fat të keqë si zakonisht ndjekur nga zhgënjim.

Mendoni se plani ishte i pasuksesshëm?

Plani është nominalisht një plan, por kjo shfaqje tregon se kjo është një veprim pa konceptim.

Mendoni se plani i veprimit duhet të ketë qen përgatitur para zgjedhjeve?

Plani ishte menduar për tu bërë. Nëse dikush dëshiron për të qeverisur dhe të merret me biznes serioz, atëherë ka për të bërë përgatitje serioze. Mesa duket kjo qeveri nuk bërë përgatitje serioze, ato filluan plani 21 në publik, i cili nuk është realizuar ende. Kryeministri do li me një buzzword shumëinteresant, që në fakt ai nuk premtoj asgjë, dhe për këtë arsye asgjë nuk është bërë. Njerëzit duhet të pysin kryeministrin si erdhi ai në pushtet, sepse në një demokraci, njëri është i zgjedhur për shkak të fuqisë së fjalëve të tij ose të saj dhe jo duke përdorur përdorimin e armës, forks bajgat, polet, tanke dhe topat. Njerëzit ishin, në kontekstin e semiotikës, dhe politikës e demokracisë, pas fjalës.

Premtimet?

Po premtimet aktuale.

² Alexis de Tocqueville (1805–1859). Skencëtari politik francez, tradita klasike liberale politike.

³ Joseph Schumpeter (1883–1950). Ekonomist austrian-amerikan dhe skencëtar politik.

⁴ Adam Przeworski (1940, Warsaw). Profesori polak-amerikan i skencave politike, merret me teorinë e demokracisë dhe politikës ekonomike.

⁵ Karl Popper (1902, Vjenë, Austri-Hungari - 1994, Londër). Një nga filozofët më të mëdhej të shekullit të 20.

3. Mund të përshkruani shkurtimisht paralelet mes të tanishëm dhe të ish qeveris?

Qeveria e mëparshme kishte një themel ideologjik të ndryshme. Qeveria e mëparshme ishte kristian-demokratike-konservatore në orientim e cila drejtoj Kroacin në një total prej 16 vjetësh dhe është kryesisht përgjegjës për situatën e tanishme. Ish qeveria krijoi shtetin në mënyrë të konsiderueshme, por thjesht ka dështuar në formatimin e shoqërisë kroate. Tragjedia është se qeveria e re, e cila ka pasur një shans për të dalur nga pozicioni pashpres, thjesht nuk përfitoi nga mundësia e dhënë. Kështu, me metodën të krahasimit sociale, ne mund të themi se ka pasur një zhvendosje të pushtetit në nivel botëror, edhe pse kjo është e diskutueshme, por në fakt asgjë nuk ka ndryshuar që qytetarët të ndjehen më mirë. Ky është problemi.

II. Situata politike në nivel lokal dhe zgjedhjet lokale 2013.

1. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, dy baza zgjedhore polarizuar midis HDZ dhe SDP. Si e komentoni ju këtë, mendoni se mund të jetë një tregues i demokracisë që mungon nga shoqëria kroate? Ngjarjet politike në 2012 ndryshuan diçka në shpërndarjen e forcave midis partive të mëdha?

Fakti është se janë dy pole, rezultati i polarizimit në shoqëri. Është gjithashtu një rezultat i njëzet vitëve të polarizimit krijuar nga ana e dy partive të mëdha, që kanë kolonizuar hapësirën shoqërore dhe politike të shoqërisë kroate, duke mos lënë mundësinë për parti të tjera të vijnë të parat. Të dy partitë më të mëdha ndan hapësirën, dhe pastaj sferën e influencës. Ato janë mirë organizuar me një infrastrukturë të fortë, me aspekte të partonazhit të forta së punës të tyre, që është me politikën myshtërinj-kush nuk është te njëra nga dy partitë nuk mund të luaj. Ajo merr dikush nga jashtë për të depërtuar si një lumë të tretë. Gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare u shfaq një rrymë e tretë-partia e klasës punëtore. Unë mendoj se partia laburiste do të forcohet më shumë dhe më shumë për shkak se zgjidhja socio-demokratike ka pushuar të jetë një alternativë socio-demokratike, ajo është kthyer në neo-liberal të qartë. Kritika ime themelore për socio-demokratët kroate është se ato humbën identitetin në një mënyrë që ato u orientuan më shumë drejt ideologjisë neo-liberale, politika neo-liberale dhe kështu ato u lidhën me një parti neo liberale, HNS. Një forcë e tretë është në horizont, e cila ka parasysh se dy partitë e mëdha kolonizuan në aspektin politik dhe interesin. Dy partitë më të mëdha nuk janë në konkurrencë me njëri tjetrin më, ato funksionojnë më shumë si parti si motra. Kjo është oligarkia politike e cila bashkëpunon në mënyra të ndryshme kur fiken dritat.

2. Në Maj 2013 do bëhen zgjedhjet lokale vetqeverisje. Çfarë rezultate prisni?

Nuk i ndjek zgjedhjet lokale, por parimi i zgjedhjeve lokale, presidenciale dhe parlamentare, në thelb, është e njëjtë. Kjo është një-herë-e katër pjesëmarja e vetme politike të qytetarëve kur ato kanë të bëjnë me oferta të ndryshme politike. Problemi kryesor i zgjedhjeve dhe të demokracisë minimale është një lloj e post demokracisë në të cilin depolitizimi zhvillohet. Nuk ka më diskutime në çështje publike dhe probleme, nuk ka më debate ideologjike ose konfrontime politike. Politika është bërë teknika dhe teknologjia për krijimin për pushtetin dhe zotërimin. Politikanët janë bërë sipërmarrës në politikë. Në fakt disa prej tyre janë biznesmenë si Berlusconi. Politika është bërë një kombinim së populizmës, biznesit dhe mediave. Në demokraci që qeveriset nga mediat, politikanët sjellen si tregtarët tipike politike të cilët ofrojnë mallrat e tyre në një gjurmë të sondazheve politike, për shkak se ato kanë nevojë për ato. Politikanët bashkëpunojnë me mediat dhe i gjithë procesi politik për themelimin të organëve demokratike dhe demokracia mbështet në skenë dhe apo teatrimin. Në fund të fundit, politika dhe demokracia në moshë post-moderne nuk janë asgjë por një pjesë integrale së shoqërisë së spektaklit. Një nga kolegeët e mi tha: "Kush është dallimi ndërmjet Obama dhe Lady Gaga?". Ato të dy vijnë si pjesë e një prodhimi të masë kulturës, ato përdorin PR, skenën, fazën, propagandën, reklamimin dhe përdorin teknika të njashme. Lady Gaga dhe Obama të dy dërgojnë mesazhe të masave. Obama dhe Lady Gaga janë në një pozicion të njashme, vetëm mesazhet janë të ndryshme në kuptimin semiotik.

3. Si e vlerësoni rirregullimin e marrëdhënjeve politike në Istria?

Unë mendoj se kjo nuk është një krizë, për thjesht një luftë për pushtetin dhe Këndikimin në Istria. Është një variant i vjetër IDS (Asambleja demokratike e Istrias) dhe partia tjetër SDP e cila kërkon të fitoj ndikim. Kjo është thjesht parimi i fitusve apo të humbësve dhe kjo është legjitime demokratike. Çfarë është legjitime demokratike nuk mund të quhet si krizë. Kriza është të shfuqizojsh mundësinë e zgjedhjes. Atëherë nuk do të ishte demokraci, por kriza e demokracisë. Një tjetër aktor erdhi në vendngjarje, SDP, i cili dëshiron të njejtën si IDS dhe konkurojnë. Në këtë ndeshje politike e vetmia gjë që ka rëndësi është se kush do fitoj dhe kush do humbi. Shkencëtari polak politik Przeworski argumenton se disa do humbasin sipas teorisë së zgjedhjes racionale, ndërsa të tjerët do fitojnë. Nuk ka opsion të tretë.

III. Pozicionet kroate në rajonin europian.

1. Sipas mendimit tuaj, cili është pozicioni dhe roli i Kroacisë në Europën jug-lindore?

Nga 1 Korrik 2013, në qoftë se të gjitha shkojnë mirë, dhe të ketë rrethana të reja gjeopolitike dhe kështu optika të reja në Europën jug-lindore dhe në Ballkanin perëndimor. Kështu, në kontekstin të optikës të re Kroacia do të bëhet anëtarë e plotë së Bashkimit Europian. Në këtë mënyrë ajo është tërhequr nga koncepti i Ballkanit perëndimor, dhe pas 2 Korrik do të gjej vetën në ballkonin perëndimor (Milardoc A. 2009). Ballkoni perëndimor, Pan Liber, që është në Bashimin Europian. Realitete gjeopolitike të reja do të dalin, dhe Kroacia, si një pjesë të ish-Ballkanit perëndimor, do të gjej vetën në pozitën të re në lidhje me vendet të Ballkanit perëndimor. Në këtë mënyrë, Kroacia do të bëhet tërheqëse qoftë si një shoqëri tranzit apo një shoqëri në të cilën ajo do të jetë e dëshirueshme për të jetuar dhe të punuar. Kroacia do të hyjë në sistemin e Bashkimit Europian nën rregullat që duhejt të ndihen dhe do të ketë të njejtat probleme si anëtarët e tjerë së Bashkimit Europian. Kroacia do të jetoj në të njejtën çati si anëtarët e tjerë, por sigurisht që nuk do të ketë të njetën status si vendet më të zhvilluara. Do të jetë si Hungaria, Sllovenia, Bullgaria, Sllovakia, Rumania dhe Irlanda 'Third League West'. 'Second league west' janë Spanja, Republika Çeke, Austria dhe Italia. Ndarja e parë e perendimit përkatet nga më të avancuara: Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Polonia. Realitete të reja duhet të afrohen racionale dhe të drejta, dhe çfarë shikohet është nevojë për tu thënë. Këto janë realitetet të reja së Bashkimit Europian, të cilat i shfaqen edhe në librin tim të ri të quajtur "Three essays on euro skepticism"-dhe semiotika e euro-skeptizimit. Nga 1 Korrik, koncepti makro-rajonal do të ripërcaktohet duke pasur parasysh realitetet të reja gjeopolitike. Fakti është se Kroacia dhe të bëhet anëtarë i ri i Bashkimit Europian. Si do të vazhdojë të sjellet me pjesën tjetër të Ballkanit perëndimor varet nga qeveritë nga anën tjetër të kufirit.

2. Udhëheqja në Serbi ka ndryshuar. Çfareë mundësi apo vështirësi shikoni ju për bashpunimin mes dy vendeve?

Marrëdhënjet kroato-serbe janë në një nivel shumë të ulët, e cila është llogjike, sepse presidenti Tomislav Nikolić me politikën e tij të tanishme krijon probleme. Nuk mund të flasim për normalizimin të marrëdhënjeve, ndërsa aji thotë se Vukovar është një qytet serb, se në Srebrenicë nuk ndodhi ajo që ndodhi ose se Mali i Zi është ende pjesë e Serbisë. Presidenti Nikolić duhet të marrë përsëri të gjitha që aji ka thënë dhe të përputhet me rregullat. Në këtë mënyrë, ai mund të qeveris dhe të çoj Serbinë në një mënyrë më të mirë. Deri presidenti Nikolić të tërheqi deklaratat e tij, jo presidenti ynë, por as presidentët e tjerë do shkojnë në Beograd. Kjo do të thotë vdekje politike për presidentin Josipović. Edhe pas pranimit së Kroacisë në Bashkimin Europian, nuk shoh asnjë mundësi për mirëkuptim të ndërsjellë. Kjo ishte një opsion kur Boris Tadić ishte president, por tani ai është zhdukur. Tadić dhe Josipović komunikoshin në një nivel miqësor. Sa i përket Bosnjës Herzegovinës, kur ne jemi duke folur për këtë makro-rajon, nuk kishte asnjë përzirje të brendshme. Bosnia dhe Hersegovina duhet të konstituohet në një mënyrë se ajo strehon tre etni të ndryshme, pasi është një demokraci etnik.

3. Mendoni se pas anëtarësimit në Bashkimin Europian, një skenar i njashëm mund të ndodhë në Kroaci siç ka ndodhur në Slloveni?

Ka një mundësi që të ndodhë skenari i sllovenisë-ndështa edhe para anëtarësimit të Kroacisë në Bashkimin Europian. Në qoftë se numri i të papunëve kalon 400.000 masa do të dali jashtë në rrugë. Në këtë kuptim ka dy skenarë. Është një skenar me intesitet të ulët konflikti ku konflikti mund të ndodhin pa ndryshime të mëdha. Skenari me intesitet të lartë konflikti do të dilte në një situatë kaotike. Mënyra për situatën kaotike do të ishin zgjidhjet parakohshme. Unë do të argumentoj për zgjidhje parakohshme parlamentare dhe presidenciale. Do të ishte mirë nëqoftëse ato do bëheshin bashkë me zgjidhjet lokale në Maj. Pse? Sepse unë nuk besoj në aftësinë e grupit në pushtet të jetë në gjëndje të ndryshoj situatën në tre ose katër muaj. Unë flas në nivel racional, pa diskursin ideologjik ose dhëbshuri. Duke folur racional, në tre ose katër muaj nuk mund të kemi ndryshime të mëdha-e vetmia gjë që mund të lindi janë komplikime të reja, duke pasur parasysh se çdo ditë ka më shumë dhe më shumë të papunë. Kjo tezë automatikisht provokon pyetjen: Kush do të vë në pushtet nëse bëhet fjala për zgjidhje të parakohshme? Opozita nuk është e gatshme. Në fakt, nuk është aq shumë në lidhje me nëse ato janë të gatshëm apo jo, por nëse është fjala për konflikt me intesitet të lartë, atëherë gjithçka duhet të ruhet me zgjedhje të parakohshme, që përfundimisht të gjejnë një formulë optimale qeveritare. Ajo mund të jetë e bazuar në një koalicion të madh, në një koalicion të vogël, qeveria e unitetit kombëtar, qeveria e shpëtimit kombëtar, komiteti i sigurisë publike. . . Për ne qytetarët nuk ka rëndësi se si do quhet. E vetmia gjë që ka rëndësi është se ekipi që merr gjërat në duart e tij duhet ta bëjë siç duhet. Numri i të papunëve duket se do bëjë në Maj për shkak se nuk jemi të "rastit", por një shtet pavnjë plan

fuksionimi i të cilit varet nga ndryshimet klimatike, për shkak të sezonit turistik. Me pak fjalë, qeveria do të shpëtohet nga sezoni turistik, por kjo është thjesht një zgjedhje e përkohshme. Megjithatë, ajo mund të vëri të shkallëzimi i pakënaqësisë edhe para hyrjes në Bashkimin Europian. Në këtë rast, bashkësia ndërkomtare do të rrezojë kryeministrin Milanović dhe të vejë dikush tjetër në pozicionin e tij. Kjo quhet afirmim post demokratike dhe teknokratike të politikës. Kjo është ajo që unë shoh dhe ajo që unë mund të kandidojë në bazë të faktëve, në bazë të shifrave, bazuar në marrëdhënjet, procesëve, pritjeve dhe tendencave.

4. Cilat janë karakteristikat rajonale të Kroacisë? Ju lutem mendohuni mbi vantazhet dhe disavantazhet e një konceptim të tillë.

Sa i përket rajonalizimit të brendshëm, pas bashkimit me Bashkimin Europian, Kroacia do të ndahet në dy ose tre rajone statistikore. Në ndarjen e re rajonale, shtetet, e cilët duan të mbajnë pushtetin e tyre, duket se do kundërshtohen me ndarjen e brendshme statistikore. Për Bashkimin Europian është shumë e lehtë për të vepruar në dy ose tre makro rajone, sesa me njëzet e një. Në këtë mënyrë është më e lehtë dhe e thjeshtë për të vepruar me fondin e destinuar për zhvillimin rajonal. Bashkimi Europian shkon për thjeshtimin, sa niveli operacional merret parasysh. Në përmbledhje, është më e lehtë për të komunikuar me tre makro rajone sesa me 21 shtete.

Mendonit se identiteti i shtetëve mund të humbet me ndarjen e re rajonale?

Unë nuk shoh sepse kjo do të çojë në humbjen e identitetit. Kur merret parasysh identiteti, nëse një person ose grup shoqëror ose rajon do të humbi identitetin atëherë do ta humbi. Vetëm duke hyrë në një lloj marrëdhënjeve të re, a priori, identiteti nuk humbet. Ajo mund të humbet nëse një person pranon humbjen, por ende të gjitha varen nga individualët ose nga grupet shoqërore. Mbështetja kryesore është gjithmonëbrënda jo jashtë. Dikush nga jashtë mund të ketë ide, koncepte ose plane që ai është duke u përpjekur për të imponuar ato, por objekti i imponuar gjithmonë mund të sigurojë rezistencën, kështu që ajo të jetë në jetën e përditshme.

IV. Euro-skeptisizmi.

1. Ekziston euro-skeptisizmi në Kroaci?

Jo, është një produkt artificial. Megjithatë, euro-skeptisizmi do të fillojë me bashkimin e Kroacisë në Bashkimin Europian. Pastaj ajo më në fund do vijë në jetë. Ajo do të rrjedhë nga procesi i vërtet, marrëdhënjeve midis aktorëve të procesit, marrëdhënjet e pushtetit. Kjo është më shumë një hyrje, puthja në bazën të diskursit ideologjik dhe nuk është bazuar në eksperiencën. Euro-skeptisizmi i vërtet dhe gjithçka që ekziston është bazuar në eksperiencën. Gjërat mund të drejtohen nga metafizika, teologjia ose ideologjia. Por në qoftë se ajo nuk mund të vërtëtohet empirikisht, atëherë nuk ka shumë themel.

2. Pas pranimit të Kroacisë në Bashkimin Europian, si do jetë politika e saj e jashtme?

Politika e jashtme kroate do të jetë politika e jashtme të Bashkimit Europian. Kjo zakonisht do të jetë zbatimi i politikës së jashtme të BE. Ajo që tani është e jashtme dhe individuale, ajo do të jetë në grupin e krahasuar me Kinën, Amerikën dhe Australin. Kjo është një politike eurocentrike. Kjo është politika e Brukselit sipas të cilit çdo shtet përcakton politikën e saj të jashtme për interesat e tyre. Për shëmbull, prioriteti do të jetë politika e jashtme ndaj shtetëve të Ballkanit perëndimor. Më pas, mund të jetë e mundur përcaktimi i politikës ndaj Rusisë dhe politikacë të lindjes. Kroacia aktualisht nuk ka asnjë politikë të definuar as me Kinën, Rusinë ose Indin. Në fakt ajo sjellet jashtëzakonisht në një mënyrë eurocentrale. Kroacia nuk përkrah konceptin e hapjes ndaj botës që mund të ndërtojë një marrëdhënie të veçantë me atë të mëdhej. Me pak fjale nekemi dy opsione: Kroacia është për të a) zbatuar politikën e jashtme të Bashkimit Europian dhe b) në lidhje me pozicionin e saj gjeopolitike do të krijojë politikë të veçantë të huaj në përputhje me interesat e veta.

Zagreb, 8 Janar 2013.

© DKE 2013

<http://www.southeast-europe.org>
dke@southeast-europe.org

Shënim: të respektuar kërkues noqëftëse bëni një referim të artikullit ose përmendni një pjesë të tij, ju lutemi në çoni një e-mail në adresën: dke@southeast-europe.org që të na bëni njoftim. *Ju lumi shënoni artikullin kështu:*

Ivana Jukić - Csaba Surányi: Hyrja e Kroacisë në Bashkimin Europian. Demokraci, zhjedhjet, politika dhe shoqëria. (Përktheu: *Elsa Kryeziu*) *Délkelet Európa – South-East Europe International Relations Quarterly* (Dimër 2012) ff 1-5.

Faleminderit për mirëkuptimin. *Kryedaktori.*